

**UDHËZIM**  
**Nr. 3, datë 19.2.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 15.8.2014 “PËR ZHVILLIMIN  
PROFESIONAL TË PUNONJËSVE ARSIMORË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 58 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007, "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë" dhe të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për lejet, autorizimet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Pika 2 e nenit 6 të udhëzimit nr. 26, datë 15.8.2014 "Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë", ndryshon si më poshtë vijon:

“Tre ditë trajnimi përmbajnë 18 orë dhe pasqyrojnë 1 kredit.”.

2. Pika 3 e nenit 6 të udhëzimit nr. 26, datë 15.8.2014, "Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë" ndryshon si më poshtë vijon:

“Një punonjës mësimor duhet të realizojë së paku tre ditë trajnimi në vit.”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, IZHA, AKP, ISHA, DAR/ZA, institucionet arsimore dhe agjencitë trajnuese.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**Lindita Nikolla**